



Kompostimi në Maqedoni - Alternativë e shëndoshë apo vetëm një ide e “kalbur”?

Analitika
- Tetor, 2008 -
www.analyticamk.org

Hyrje

Në Unionin Evropian (UE), vend me 497 milionë banorë, bio-plehrat përbëjnë 30-45% të plehrave komunale të ngurtë (PKN). Derisa në Maqedoni, shtet me vetëm dy milionë banorë, përqindjet e bio-plehrave arrijnë përafërsisht përqindjet e UE-së, saktësisht 26,2 %. Në Maqedoni, me bio-plehra nënkuptohen mbeturinat me prejardhje organike (shtazore dhe bimore) dhe atë mbeturinat shtëpiake, ushqimi si mbeturinë nga restorantet, kantinat dhe tregjet e gjelbërta, si dhe plehrat nga komunat rurale - plehra nga aktivitetet blegtorale-bujqësore, plehrat nga kopshtaritë. Për shkak të përmbajtjes së gjerë të ujit, dendësisë së madhe (përfshirë bëjnë plehrat e gjelbërta, të cilët kanë dendësi të vogël) dhe fermentabiliteti i lartë i këtij lloji plehrash, është shumë e rëndësishme që i njëjti të jetë i kyçur në menaxhim të integruar dhe të qendrueshëm të plehrave

Rezultate pozitive në zvogëlimin e bio-plehrave mund të arrihen përmes metodave të vjetra ose të reja siç janë kompostimi, digjestrioni anaerob (DA) i ushqimit, plehrat e gjelbërta, riciklimi i letrës dhe tekstilit përmes trajtimit mekanik biologjik (TMB) dhe insenerimi.

Bio plehrat – problem që sfidon

Në kuadër të UE-së, në Direktivën për plehrat (1999/31/EC) bio plehrat janë të definuar si “cilado qoftë mbeturinë që mund të dekompozohet përmes metodave dekompozuese aerobe dhe anaerobe, si ushqimi dhe plehrat e gjelbërta si dhe letra dhe kartoni”. Në UE, fatin e këtyre materialeve e caktojnë akte specifike.

Duke e analizuar situatën e bio plehrave në Maqedoni, vërehet se ka zbrazëtira në analizat kualitative të plehrave, si pasojë e të cilës mundësohen vetëm vlerësime të sasisë së plehrave. Problemi me bio plehra në Maqedoni është dyfytyrësh. Nga njëra anë është fraksioni bio-dekompozues i PKN si një nga fraksionet kryesore të plehrave të krijuara në Maqedoni, dhe në anën tjetër janë plehrat nga sektori bujqësor.

Bujqësia tradicionalisht është ndër tre sektorët më të rëndësishëm në ekonominë e Maqedonisë. Praktikata tradicionale intenzive bujqësore (ende të vjetëruara) rezultojnë në implikacione të dëmshme mbi ambientin jetësor si ndotja e tokës, ndotja e ujit, humbja e biodiversitetit të bashkësive dhe pejsazheve, në të njëjtën kohë duke ndikuar në rritjen e plehrave bujqësore dhe plehrave nga ushqimi. Rreth 5,2 deri 6,8 milionë ton në vit janë plehra bujqësore, prej të cilëve rreth 4,2 deri 6,8 janë plehra nga inde shtazore ndërsa rreth 0,496 deri 0,523 milionë ton plehra bimorë për vit, paraqesin fraksionin ricikluar në aktivitetet bujqësore.

Kompostimi- zgjidhje alternative në vendosjen e bio plehrave në deponi

Në Maqedoni, prej të gjitha teknikave të menaxhimit me plehra, vendosja e plehrave nëpër deponi në vitin 2004 është e përfaqësuar me 97 %, ndërsa kompostimi me 0%. Krahasuar me UE-në, në vitin 2004, 47 % e mbeturinave të përgjithshme komunale u janë nënshtruar deponive, ndërsa për ripërtëritjen e materialeve janë përdorur 36 % e mbeturinave komunale.

Zgjidhje për normën e lartë të vendosjes së plehrave nëpër deponi në Maqedoni, si dhe zgjidhja e mungesës së kapacitetit për vendosjen e PKN, mund të gjindet në **drejtimin e menaxhimit me bio plehrat kah kompostimi**.

Kompostimi paraqet process të kontrolluar ku mbeturinat organike të mbledhura dhe të segreguara vendosen nën dekompozim mikrobiologjik në kushte aerobe, duke dhënë produkt përfundimtar-kompost me përmbajtje të lartë organike, me karakteristika kryesore të vlefshme si **shtesë për**

tokën, për përmirësimin e e strukturës dhe kualitetit të tokës, si dhe shtesë në formë mbeturinash për materie me përmbajtje elementësh azoti, fosfori, dhe kaliumi.

Çfarë është bërë deri tani në Maqedoni në aspektin e legjislacionit për kompostim krahasuar me legjislacionin e UE-së për kompostim?

Legjislacioni I UE-së relevant për trajtim biologjik të mbeturinave

Paraqitja e mundshme e një Direktive evropiane të pavarur për trajtim biologjik të bio plehrave u shua me shpalljen e Komisionit Evropian për largimin e idesë për përafrim të shteteve të UE-së në lidhje “me udhëheqjen aq të dëshiruar të shteteve anëtare drejt përmbushjes së qëllimeve të Direktivës për deponitë.” Instrumente alternative ishin ofruar kryesisht në strategjinë tematike për preventivë ndaj mbeturinave dhe reciklim, e cila parasheh dispozita kualitative për kompost dhe instalacione për kompostim, me qëllim që të përmirësohen kushtet e tregut. Gjithsesi, sipas asociacioneve për kompostim, strategjia tematike për preventivë ndaj mbeturinave dhe reciklim është joadekuate dhe e dobët që të zgjidh problem të tillë të ambientit jetësor.

Në nivel të UE-së, kërkesat kyesore legjislative për bio plehra kanalizohen përmes Direktivës Kornizë për mbeturina (75/442/EEC me ndryshime prej 91/156/EEC) e cila vendos kornizë për menaxhim me mbeturinat nëpër tërë bashkësinë evropiane, si dhe përmes Direktivës për deponitë (1999/31/EC) e cila vendos kërkesa specifike për dizajnim, operim dhe përkujdesje ndaj deponive si dhe për llojet e mbeturinave të cilat mund të pranohen në deponi.

Legjislacioni në Maqedoni relevant për trajtim biologjik të mbeturinave

Nga shqyrtimi i legjislacionit maqedonas për menaxhim me mbeturina, vërehet se termi kompostim në **Ligjin për menaxhim me plehra** është i cekur në mënyrë të paqartë. Ky ligj kornizë siguron dispozita të përgjithshme të cilat kanë të bëjnë me: definimin dhe aplikativitetin e llojeve të mbeturinave, stretegitë, planet dhe programet të formuluar në nivele të ndryshme, procedurat për menaxhim me mbeturina dhe nxjerja e lejeve, masat sanksionuese etj. Ministria e ekologjisë dhe planifikimit hapësinor (MEPH) është përgjegjëse për implementimin dhe zbatimin e këtij ligji.

Ligji për menaxhim me plehra është në lidhmëri edhe me legjislacione tjera, relevante për menaxhim me bio plehra dhe kompostimin si proces. Me rëndësi të veçantë janë edhe Ligji për mbeturina dhe Ligji për produkte-nus me prejardhje shtazore, i cili e rregullon kategorizimin, mbledhjen, transportin, trajtimin, përdorimin dhe vendosjen e produkteve-nus me prejardhje shtazore, derisa **Ligji për plehra** vendos termet dhe kushtet për prodhim, llojet, përdorim, kualitet, kontroll të kualitetit, shitje dhe inspeksion të plehrave artificial. Sipas sistemeve moderne të kompostimit, **Ligji për kualitet të tokës** duhet patjetër të jetë i përgaditur, me qëllim që të zhvillohet tregu për kompost dhe në të njëjtën kohë të fitohet besimi i përdoruesve të fundit ndaj këtij produkti. Ligji do të sigurojë bazën e nevojshme ligjore për kërkesat për kualitet të kompostit si shtesë për tokën.

Procesi i implementimit: Nga pilot projekti drejt qëndrueshmërisë

Maqedonia përgaditet të vendosë shkallë të reduktimit të bio plehrave të deponuara, dhe atë 75% deri në vitin 2015 dhe 50% reduktim deri në vitin 2020. Në perceptimin aktual të sistemit të menaxhimit me bio plehra, i njëjti është i paraqitur si ngarkesë financiare shtesë në shpenzimet totale për menaxhim me plehra. Sidoqoftë, siç është e theksuar në Strategjinë kombëtare për menaxhim me plehra (2008-2020), këto investime do të bëhen të paevitueshme në fund të kohës kornizë për implementimin e strategjisë së menaxhimit me plehra. Komunitat, përmes mjeteve të tyre,

planifikojnë, investojne si dhe stimulojnë sektorin privat të investojë në kapacitetet e vogla për trajtim të bio plehrave. Në kohët e sotme pilot projekte janë paraparë vetëm në disa komuna në Maqedoni si Ilindeni, Velesi, Gazi Baba, Koçani. Të njëjtat janë paraardhës të kompostimit në Maqedoni, por si pasojë e çështjeve të pazgjidhura si mungesa e zbatimit të legjislacionit egzistues, mungesa e standardeve nacionale për kompostim, mungesa e mbledhjes së organizuar të PKN dhe plehrave bujqësorë, niveli i ulët i vetëdijes së qytetarëve, mungesa e shfrytëzuesve potencial dhe e tregjeve të kompostit si dhe mungesa e strukturës organizative menaxheriale për aktivitete projektsh, mbeten vetëm si pilot projekte, gjë që ndodhi me komunat Zërnovc dhe Resnjë.

Determinantët matës të kompostimit

Implementimi aktual i planeve për menaxhim me bio plehra, përmes pilot projekteve dhe kornizës së vendosur ligjore të Ligjit për menaxhim me plehra, duhet të përforcohet, që të mundësojë rruajtjen e natyrës dhe të sigurojë vend më të pastërt dhe më të sigurtë për jetesë. Rekomandimet që do të mundësojnë qasje detajuese dhe bashkëkohore të kompostimit si opsion për menaxhim me plehra janë si vijojnë:

- Implementim i Ligjit për menaxhim me plehra, me veprim qenësor të Inspektoriatit shtetëror të ambientit jetësor, si sektor në MEPH. Ky sektor ka nevojë për përforcim institucional, me qëllim që inspektorët të arrijnë të mbulojnë sa më shumë territorin e Maqedonisë me inspeksione të integruara dhe të menaxhuara drejtë;
- Kampanja për rritjen e vetëdijes publike për implementimin e Ligjit për menaxhim me plehra, të udhëhequra nga MEPH dhe vendimmarrës tjerë me relevancë. Gjithashtu instrumentet ekonomike duhet të drejtohen kah ndryshimi i sjelljes, e jo vetëm kah “mbledhja e tatimeve”.
- Organizimi i punëtorive të ndryshme në nivel komunal për krijimin e programeve lokale për planifikimin e menaxhimit me plehra, me qëllime adekuate të reduktimit. Bashkëpunimi ndërmjet pushtetit qendror dhe atij lokal dhe stimulatorët adekuat janë qenësorë drejtë një kompostimi të qendrueshëm;
- Thjeshtësimi i rregullatave egzistuese, ndërsa dispozitat për futjen, procesimin dhe aplikimin e produkteve duhet të zhvillohen me qëllim që të evitohen barrierat e mundshme.
- Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe e ujërave si vendimmarrës kryesor për bujqësinë organike, duhet të promovon prodhimet organike dhe në të njëjtën kohë të sigurojë trajnime të blerësve potencial (kryesisht bujqit) për përdorimin e kompostit. Tregu i kompostit duhet të jetë në plan të parë të sektorit bujqësor në Maqedoni, para se i njëjti të hapet kah tregjet e jashtme. Krijimi dhe realizimi i marketing planit specifik për kompost është mënyrë e shëndoshë drejt realizimit të gjithë asaj që u tha më lartë.

Mjedisi jetesor, agrikultura dhe zhvillimi rural

Publkime qe vijojne

"Vleresimi i menaxhimit te ujerave " (Nentor, 2008)

"Raport i shkurter: Performancat e Maqedonise ne sferen e mjedisit jetesor" (Dhjetor.2008)

Kontakt

Analitika

Hulumtues pergjegjes per programin Mjedisi jetesor, agrikultura dhe zhvillimi rural

Dame Gruev 7-8/3
1000 Shkup, Maqedoni
tel: + 389 2 312 1948
web: www.analyticamk.org
info@analyticamk.org

Karolina Pendovska - hulumtues
kpendovska@analyticamk.org

Analitika - organizate e pavarur joprofitabile e perkushtuar per te ndihmuar persona dhe institucione ne perforcimin dhe permiresimin afatgjate te demokracise dhe udheheqjes si ne R. e Maqedonise ashtu edhe me gjere ne rajon.

Analitika eshte organizate per analize dha hulumtim te politikave publike (think-tank), e perkushtuar ne promovimin dhe zhvillimin e bashkpunimit ndermjet subjekteve dhe organizatave ne R. e Maqedonise dhe me gjere.

Publikimi i raporteve eshte i mbeshtetur nga Fondi Evropian per Ballkanin, Projekti: "Ndertimi i kapaciteteve nacionale: Harmonizimi, legjislacioni dhe menaxhimi"